

DONIKA BAKIU

**MIKROTOPONOMIA E FSHATIT GAJRE NGA ASPEKTI
SOCIOLINGUISTIK DHE ETNOKULTUROR**

811.18'373.21(497.751)

Abstrakti: Studimi përfshin aspekte etnokulturore, sociolinguistike të mikrotoponimeve të fshatit Gajre. Ky vendbanim i hershëm shqiptar, ashtu si shumë fshatra tjerë të Malësisë së Sharrit të Tetovës, është shumë i pasur me mikrotoponime origjinale shqipe. Po ashtu përfshihet historiku i fshatit Gajre, nga rrjedh emri fshatit dhe pjesa gjeografike e fshatit. Në studim po ashtu përfshihen dhe huazimet, në atë se çfarë huazimesh ka në këtë fshat për anën e mikrotoponimeve. Kemi huazime greke, sllave, turke dhe fjalë ndërkombëtare. Fjalët shqipe janë në një numër shumë më të madh pra kjo dëshmon se është vend shqiptar që në kohërat e lashta. Në këtë studim kemi mbledhur materiale nga terreni nga njerëzit më të moshuar sepse të rinjtë mund të themi se i kanë lënë në haresë. Mund të themi se çështja emikrotoponimeve nënjëfarënyre është trashëgimi kulturore e gjuhësore. Çështja e mikrotoponimeve në Republikën e Maqedonisë është një fushë e trajtuar më pak. Mikrotoponimia mund të themi se është një çështje që i tejkalon kornizat e studimeve gjuhësoredhe prek edhe në segmente të tjera të organizimit të jetës shoqërore,veçmas është temë aktuale dhe e ndjeshme në rrethana të Maqedonisë.

Fjalët çelës: Mikrotoponim, fshat, udhë, mëhallë etj.

Abstract: The study includes ethno-cultural, sociolinguistic aspects of microtoponyms in the village of Gajre. This early Albanian settlement, like many other villages of Sharr Mountains of Tetovo, is very rich with original Albanian microtoponyms. Also included is the history of the village of Gajre, deriving from the name of the village and the geographical part of the village. The study also includes borrowings, what borrowings there are in this village on the side of microtoponyms. We have Greek, Slavic, Turkish and international borrowings. The Albanian words are in a much larger number, so this proves to be an Albanian country in ancient times. In this study, we collected material from the field by older people because we can say that young people have left them in spite. We can say that the issue of microtoponymy is in some way a cultural and linguistic heritage. The issue of microtoponyms in the Republic of Macedonia is one of the least treated areas. Microtoponymy can be said to be an issue that goes beyond language learning frameworks and also affects other segments of the organization of social life, but it is a current and sensitive topic in Macedonia's circumstances.

Keywords: Microtoponyms, village, track, neighborhood, etc.

HYRJE

Onomastika është pjesë e rëndësishme e leksikologjisë, që merret me kuptimin, prejardhjen dhe shtrirjen e emrave të përveçëm si: emrat vetjakë, nofkat dhe pseudonimet (antroponimet), emrat familjarë ose siç i quajmë ndryshe edhe mbiemra (patronimet) që përbëjnë dhe njëzën nënndarje si dhe emërtimet e vendeve dhe objekteve gjeografike (toponimet), që përbëjnë edhe nënndarjen tjetër të onomastikës që në vetvete këto kanë nënndarje të tjera.

Onomastika në përgjithësi dhe toponimia në veçanti, për çdo gjuhë, përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara. Mund të themi se ajombetet

“arkivi gojor” i historisë dhe lashtësisë së kulturës të çdo kombi. Ne në këtë studim do merremi me mikrotoponiminë e fshatit Gajre të Tetovës nga aspekti sociolinguistik dhe etnokulturor.

POZITA GJEOGRAFIKE DHE HISTORIKU I FSHATIT GAJRE

I shtrirë në rrëzë të malit Sharr, e banuar sot prej rreth 3.000 shpirttrave, në rreth 120 shtëpi, ky katund ka qenë gjithmonë vatra e patriotizmit shqiptar, i konsideruar nga disa madje, si epiqendër e edukimit të malësisë në fjalë . Fshati Gajre gjendet në veri-perëndim të qytetit të Tetovës, pesë kilometra futet në Malësinë e Sharrit. Pra siç e shihni është fshat malor me të gjithë karakteristikat. Mirëpo tash mund të merret edhe si lagje, ose parlagje e qytetit, sepse në afërsi të tij kalon rruga automobilistike që lidh qytetin dhe Kodrën e Diellit, vend turistik për rekreacion të sporteve dimërore dhe verës për pushim klimaterik, për shkak të hoteleve dhe për shkak të ajrit të pastër, nga ana tjetër dhe për horizontet e pafund e të kulluar si kristali.

Gajrja është një fshat i ngarkuar me histori. Gjeografia e saj ndërlidhet me malet shqiptare të Sharrit, sipas mendimit tonë, janë malet më të bukura në botë. Shenjtëria historike e këtij mjedisi ndërlidhet me patriotët që i ka dhënë për çështjen kombëtare që të ruajnë edhe toponimet nga emërtimet latine, turke dhe së fundmi nga ato sllave.

Fshati ndahet në dy pjesë, që i ndanë proi i fshatit, pra: “andi projekt” dhe “këndi projekt”.

Fiset kryesore: Në këtë fshat, sipas burimeve historike dhe gojëdhënave ka vetëm një fis, sipas ndarjes së fiseve në tërësinë shqiptare, pra Gajren e kanë banuar vetëm fisi Krasniq. Por pas disa shekujve janë krijuar fise të reja si: Xhagadur, Vela, Kotajce, Dançaulle, Gërmaze.

Lagjet-mëhallat:Emërtimet e lagjeve janë sipas fiseve: mahalla vele, mahalla kotajce, mahalla xhagadurve, mahalla gërmaze, mahalla dançe, mahalla kase.

Etimologjia e emrit: Është shumë vështirë të japim mendim të prerë rreth etimologjisë së fshatit Gajre. Mund vetëm të themi se rreth malit Sharr janë edhe dy fshatra të tjerë me pozitë të njëjtë të lartësisë mbidetare, si: Gajrja e Dibrës, dhe Gajrja e Kaçanikut. Gajrja si katund figuron përherë të parë në dokumentet turke, në vitin 1453, kur banorët e saj ishin të përkatësisë fetare krishtere.

MIKROTOPONIMIA E FSHATIT GAJRE

Sa i takon toponimeve të fshatit Gajre, siç thamë dhe më lartë nga lashtësia janë ruajtur disa toponime, ngase pas sundimit sllav, ky fshat pësoi edhe në emërtimet e vendeve, që shumica e emërtimeve janë me rrënjë sllave ose sipas emrave të pronarëve. Kështu që duke nisur nga dalja e fshatit në të katër anët ballafaqohemi me këto emërtime:

Arat: Di Arat, Ara te Kodra, Ara te Gështojat, Arat në Vllak, Ara te Mullajni, Veldexhak, Te Ara Jukës, Te Riti, Ferishta, Sliva, Celahica, Te Brahillia, Arat e Ukës.

Malet: Pramka, Mali i Proit Thatë, Mali i Thatë, Proj i Thatë, Livadhi Madh, Pramka, Izërishte.

Kodrat:Trenajca , Te Kodra e Stojanit, Prisoj.

Krojet:Kroi Madh, KrojThat, Kroi Livadhit, Kroi Gjurit, Kroi i Voreve, Kajnaki i Kopilit, Kajnaki i Salës.

Emra gropash: Gropat e Qelit, Gropa e Çollakit.

Çeshme; Gjilibik çeshëm

Uji: Uji i Dragovodës

Burim:Izvori, Burimi i Livadhit Madh.

Livadhet: Livadhi i Caucës Pajtimit, Livadhi i Ibrahimit, Rupa, Ogradja, Bresavden, Livadhçike, Livadh Madhi, Te livadhet e Projekt, Livadhet e Zogjit.

Lumenjtë: Te Reka, Te Shkumbini.

Emra moçalesh: Moçali Liqenishtes, Izërishte, Urdha e Çollakit.

Përonjtë: ProiThat, ProiMadh, ProiXhamojs.

Mullinjët: Mullajni Xhaferit, Mullajni Dupës.

Udhët: Udhët e Veleve, Velet, e Epërme, Velet e Poshtme, Gërmazet, Shike, Kotajce, Udhët e Llaseve.

Emra urash: Urra e Xhamojs

Gurët: Gjuri Cepës, Gjuri Bardh, Gjuri Zi, Gjuri Shipes, Gjuri Kuç, Gjuri Sidollit, Gjuri Halilit.

Drunjtë: Te Ahi, Brevi, Te Brevi, Bagremi, Te Bagremi, Frashna, Te Frashna, Shtogji, Te Shtogji, Shkoza, Te Shkoza, Plepi, Te Plepi, Ara te Gështojat, Te Vneshtët.

Kulloso: RrafshaIdrizovës, TeRrafsha e Zendës, TeKorrijet

Shpella: Shpella Gjufkamenit, Shpella e Shipes.

Varret; Vori Hanifes, Vori Hajdutit, Te Di Vorzit, Te vorzit e Kataundit.

Korija(Zabele): Zabeli Te Ara Zeqirit, Zabeli te Rahi Jukës, Zabeli n'Pramka, Zabeli Babës Plak, Zabeli Plak, Zabeli Krauçit, Zabeli n'Livadh t'Madh, Zabeli Livadhit Ismailit.

Vende: Vinik, Te Guri Madh, Te e Halilit, Te Ambullonta, Te Shkolla, Ka Shkolla, Te Xhamoja.

HUAZIMET

Sipas fjalorit të sotëm të gjuhës shqipe huazime quhen: “Fjalë a njësi tjetër gjuhësore që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare”. (Jani Thomai, 2006) Huazimet leksikore, në të gjitha vendet Ballkanike janë bërë përmes një baze mjaft të gjerë edhe atë nëpër shekuj. Te mikrotoponimet e fshatit Gajre kemi numër të madh të huazimeve, ato janë: huazime sllave, huazime turke, huazime greke dhe huazime arumune.

HUAZIME GREKE

Huazime greke dallojmë, por jo shumë kemi gjetur vetëm një apelativë, ajo është SHKOLLË.

HUAZIME SLLAVE

Huazimet sllave janë më të përhapura kemi gjetur 10 apelativë, ata janë: Prisoj, Rid, Izvor, Voda, Brevi, Vllak, Ograde, Zabel, Pop, Bello.

HUAZIMET TURKE

Huazimet turke janë të përhapura në këtë të folme kemi gjetur 8 apelativë: Batak, Çeshma, Bunar, Hoxhë, Mëhallë, Xhami, Jonxhë, Sokak.

FJALËT NDËRKOMBËTARE

Nga fjalët ndërkombëtare paraqitet vetëm 1 leksemë: Ambulantë.

FJALËT SHQIPE

Në mikrotoponiminë e fshatit Gajre numri më i madh i bazave apelative është me prejardhje shqipe me gjithësej 58 leksema: Bjeshkë, gropë, çukë, gurë, kepi, kodër, lugje, mali, rrafshinë, qafë, rrahu, rrasë, shpat, shpellë, baltë, kroj, lera, liqeni, moçale, përrua, ujë, ahi, bagremi, dushku, frashëri, shtog, shkozë, plep, hithër, lisi, gështenja, vreshta, dhia, kali, lopa, dhi e egër, ujku, huti, shqiponja, zogu, livadhi, barë, lëmë, stan, xhibre, ara, fushë, mulli, udhë, urë, katund, varre, kishë, bardhë, kuqe, djegës, zi, plak, ftohtë, thatë, keq.

PËRFUNDIME

Pjesa më e madhe e mikrotoponimeve të fshatit Gajre janë të gurrës shqipe, pra me prejardhje shqipe, më pas kemi mikrotoponime me prejardhje sllave e më pas me prejardhje turke. Nuk duhet harruar kurrë se në etimologjinë e mikrotoponimisë, krahas vërtetësisë gjeografike kemi edhe atë historike. Nëse një fjalë është e huazuar në të folmen e fshatit Gajre, ku hasim emërtime vendesh, kjo është e qartë dhe e shpjegueshme dhe nuk mund të themi se aty nuk ka pas shqiptarë prej shumë kohe më parë. Studimet më të thelluara të toponimisë së vjetër, duke depërtuar në historinë e lashtësisë, ndoshta do të na çoj tek emërtesat fillestare të saj.

Vetëm nëpërmjet studimeve të tilla mund të pasurohet historia e gjuhës shqipe duke hedhur dritë mbi hershmërinë historike të gjuhës dhe popullit tonë.

LITERATURA

J.Thomai, M. S. (2006). *Fjalor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.)

Bexheti, Vebi (2014.) Studime sociolinguistike II (Përmbledhje e kumtesave nga Konferenca II Shkencore Ndërkombëtare "Gjendja dhe prespektiva e sociolinguistikës sot ", mbajtur më 1 nëntor 2013 në Tetovë, UEJL

Kadriu, Zeqir (2014.) Studime sociolinguistike II (Përmbledhje e kumtesave nga Konferenca II Shkencore Ndërkombëtare "Gjendja dhe prespektiva e sociolinguistikës sot", mbajtur më 1 nëntor 2013 në Tetovë, UEJL

Kryeziu, Bahtijar (2000). *Onomastika e Hashanisë* , Instituti Albanologjik i Prishtinës , Prishtinë

Murati, Qemal (2008). *Fjalor toponomastik i tërthoreve shqiptare të Maqedonisë*, Seminari i Albanologjisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës

Ibrahimi, Mustafa (2010). *Mikrotoponimet në vendbanimet shqiptare të rrethit të Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Interlingua: Shkup

Idrizi, Xhemaludin (2008). *Mikrotoponimia e Karshiakës së Shkupit*, Shkup